

# Seminar 1 ditor me titull “Një jetë me në qendër Zotin”

Përshëndetje të dashur vëllezër dhe motra!

Të dielën, me datë 17 qershor në qendrën e Korçës u organizua një seminar 1-ditor për të ftuarit që e kanë marrë tashmë Ardhien e Dytë, pasi kishte shumë interes prej tyre për të ditur më shumë.

Tema e seminarit ishte: “Një jetë e përqëndruar tek ZOTI” dhe u dhanë leksionet “Jeta e Besimit” , “Tre detyrat e jetës së besimit” , “Kursi Formulë, Dëshmia” dhe “Lëvizja e Unifikimit”. Këto leksione ngjallën shumë interes tek të ftuarit dhe tek anëtarët në të njëjtën kohë. Ata u shprehën shumë të entuziasmuar

Gjatë gjithë seminarit u ndje një atmosferë shumë e lartë shpirtërore, të rinjtë dëgjonin me shumë vëmendje e leksionet që për ta ishin të reja. Ishte një orientim për rrugën që duhej të ndjeknin tashmë për të njohur më mirë Prindërit e Vërtetë.



Një pikë tjetër interesante e seminarit ishte koha e drekës, e cila u shërbye në natyrë. Më pas u organizuan disa lojra të cilat e rriten edhe më tepër energjinë dhe pozitivitetin e seminarit.



Ky

seminar e realizoi qëllimin e tij për ti lidhur të ftuarit e rinj më tepër me Zotin dhe Prindërit e Vërtetë. Më poshtë mund të lexoni edhe disa nga reflektimet e pjesëmarrësve që e vërtetojnë më së miri këtë fakt.

Ky seminar më shërbeu si një shtysë për të më mësuar më shumë për Zotin dhe mbi besimin në përgjithësi. Gjithashtu ky seminar më tregoi se nuk është e mjaftueshme vetëm të besosh në Zot por duhet edhe ta përhapim atë. Kur unë dëgjova për herë të parë për Prindërit e Vertete mu duk e çuditshme, por më pas kuptova se ata janë të ndryshëm nga ne njerëzit e tjerë. Prandaj më la të kuptoj se edhe unë duhet të veproj si ata.

Kristi

Pjesa më interesante për mua ka qënë konceptimi prind-fëmijë ose më saktë baba-fëmijë. Pas një marrëdhënie të vështirë që unë kam me babain tim, e kam pasur shumë të vështirë të kem një kuptim të qartë për këtë lloj mardhënie, por tani mund ta shoh nga një këndvështrim tjetër, p.s.h se si mund ti japësh dicka dikujt që me siguri ai nuk e ka ose nuk e di, është dicka që të bën të ndihesh mirë. Kjo lloj ndihme ose ngrohtësie atërore ishte e nevojshme. Këndvështrimi im për Prindërit e Vërtetë është i ndryshëm nga ai i fillimit. Sa më shumë dëgjoj për ta aq më shumë bindem për vendosmërine dhe palëkundshmërinë e tyre, në një botë shumë të vështirë.

Mariglen Mulla

Të gjitha leksionet ishin të mrekullueshme jo si paraqitje, por kishin një kuptim të thellë shpirtëror. Jeta ime e besimit pas këtij seminari do jetë gjithçka ndryshe, e gjithë jeta ime do lidhet me leksionet e parimit, me Zotin, me PV, pa menduar për veten, e gjithë jeta ime do jetë jeta për të tjerët.

Kevin Shehollari

Leksioni që më ka pëlqyer më shumë është “dëshmia”. Përsa i përket PV mendoj që janë në pozitën më të lartë, që kur kam dëgjuar për ta ka ndryshuar kënvështrimi im për botën përreth. Gjithçka që dija ishte asgjë përpara kësaj.

Kleant Caushi

Kalofshi mirë dhe bekimet e Zotit qofshin me ju.